



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.173 dt.31.10.1997

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Tiranës, i mbledhur me dt.31.10.1997, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Ndërtim Strehimit “Për çeljen e fondit për qëndrimin në hotel “Arbëria” të familjeve Buneci” bazuar në Ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, si dhe VKM Nr.441, dt.15.08.1994 “Rregullore për kompetencat dhe detyrat e administratës së Bashkisë dhe të Komunës”

**VENDOSI**

1. Të miratojë ng atë ardhurat e Bashkisë çeljen e fondit prej 370.000 Lekë për financimin e qëndrimit në hotel “Arbëria” të familjeve Buneci për periudhën 9 Janar – 30 Shtator 1997.
2. Të miratojë çeljen e fondit nga të ardhurat e Bashkisë për qëndrimin e këtyre familjeve në hotel “Arbëria” për periudhën 1 Tetor 1997 deri 15 Nëntor 1997 sipas faturave që do paraqesi hotel “Arbëria”.
3. Afati financimit nga Bashkia për qëndrim në hotel “Arbëria” do të jetë deri në dt.15.11.1997.
4. Mbas datës 15 Nëntor 1997 Bashkia e Tiranës nuk merr përsipër financimin e qëndrimit të familjeve Buneci në hotel dhe në procesin gjyqësor me palë dëmtues dhe i dëmtuar (nëse është hapur) Bashkia e Tiranës të bëjë kërkesë që të futet menjëherë si palë e interesuar për të detyruar dëmtuesin që ti paguaj Bashkisë shumën për shpenzimet e qëndrimit të familjeve Buneci në hotel për periudhën 09.01.1997 – 15.11.1997.
5. Ngarkohet Drejtoria e Ndërtim Strehimit, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**

